

VITI I DYTË

Drejtimi: Kompjuterikë

Semestri i III.

Nr.	Lënda	ECTS	Orët	Lloji
1.	Elektronika	5	(2+2+0)	O
2.	Matematika 3K (vetem per drej. e Kompj.)	5	(2+2+0)	O
3.	Sinjalet dhe sistemet	5	(2+0+2)	O
4.	Bazat e të dhënave	5	(2+0+2)	O
5.	Programimi i orientuar në objekte	5	(2+0+2)	O
6.	Interneti	5	(2+0+2)	O
Gjithsejtë:		30	24	

Semestri i IV.

Nr.	Lënda	ECTS	Orët	Lloji
1.	Arkitektura e kompjuterëve	5	(2+0+2)	O
2.	Rrjetet kompjuterike	6	(2+0+2)	O
3.	Siguria e të dhënave	7	(3+0+2)	O
4.	Komunikimi njeri-kompjuter	6	(2+0+2)	O
5.	Lëndë jo teknike:	6		Z
	1. Menaxhmenti		(2+1+0)	
	2. Menaxhimi i projekteve		(2+1+0)	
Gjithsejtë:		30	20	

Modeli i Planit mësimor të lëndës
Syllabusi

Departamenti: Elektronika, Automatika, Sistemet elektroenergjetike, Elektroenergjetika industriale, Kompjuterika, Telekomunikacioni

Fakulteti/Njësia akademike: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Titulli i kursit (lëndës mësimore): Elektronika

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor / Obligative

Viti i studimeve dhe semestri: Viti i dytë, Semestri III

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 5

Numri i orëve: 2+1+1

Koha/lokacioni: E hënë, 14⁰⁰ : 16³⁰, Salla 626
E enjte, 12³⁰: 14⁰⁰, Salla 626

Mësimdhënësi i kursit: Dr. sc. Myzafere Limani, Prof. Asc; Zyra: 627, Telefoni: 038 554 896, e-mail: myzafere.limani@fiek.uni-pr.edu,

Termimi i caktuar për bisedë me studentë:

- e hënë: 12⁰⁰ : 13⁰⁰

Qëllimet e kursit (modulit):

- Të ofroj një hyrje në konceptet themelore në lëmin e elektronikës. Ky kurs do të jetë njëri prej kurseve fundamentale për të gjitha drejtimet e inxhinierisë elektrike.
- Të përgatisë studentët për kurset më të avancuara nga lëmi i elektronikës.

Parakushtet: Bazat e elektroteknikës

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

- Të kuptoj bazat e elektronikës brenda fushës së inxhinierisë elektrike
- Të kuptoj qarqet e diodave dhe modelet
- Të kuptoj qarqet me transistor bipolar dhe FET si dhe modelet e tyre
- Të analizoj qarqet me transistor për sinjale të vogla
- Ka njohuri të analizoj dhe shfrytëzoj amplifikatorët operacional
- Analizoj amplifikatorët me riveprim
- Të marrë kurse të avancuara nga elektronika dhe qarqet elektrike.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, zgjidhje e problemeve, ushtrime laboratorike, projekte, diskutim dhe punë në grupe.

Literatura bazë: *M. Limani:* Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Plani i detajizuar i mësimit për një semestër:

Java e parë: Konceptet themelore, rryma tensioni, ligjet e Kirchhoff-it, teorema e Norton-it dhe teorema e Thevenin-it

Literatura: *M. Limani:* Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e dytë: Qarqet alternative, ekuacionet, rezonanca, funksioni transfer, qarqet me katër pole, filtrat dhe amplifikatorët

Literatura: *M. Limani:* Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e tretë: Qarqet me dioda, zener dioda, drejtuesit, dhe qarqet e ndryshme me dioda për përpunimin e sinjalit

Literatura: *M. Limani:* Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e katërt: Transistorët bipolar, konfiguracionet themelore të qarqeve me transistor bipolar, modelet për sinjale të vogla,

Literatura: *M. Limani:* Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e pestë: Konfiguracionet themelore të amplifikatorëve: me emiter të përbashkët, me bazë të përbashkët dhe me kolektor të përbashkët

Literatura: *M. Limani:* Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e gjashtë: Vlerësimi i parë intermediar

Java e shtatë: Transistori me efekt të fushës, parimet e punës, modelet për sinjale të vogla

Literatura: *M. Limani:* Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e tetë: Konfiguracionet themelore të amplifikatorëve: me surs të përbashkët, me gejt të përbashkët dhe me drejn të përbashkët

Literatura: *M. Limani:* Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e nëntë: Transistorët MOSFET, qarqet amplifikuese shumë stadesh
Literatura: *M. Limani*: Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e dhjetë: Vlerësimi i dytë intermediar

Java e njëmbëdhjetë: Amplifikatorët operacional, karakteristikat ideale dhe reale, qarqet themelore me amplifikator operacional, zbatimet e AO
Literatura: *M. Limani*: Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e dymbëdhjetë: Elementet e riveprimit, amplifikatori diferencial
Literatura: *M. Limani*: Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e trembëdhjetë: Mbledhja e të dhënave dhe kontrolli i proceseve, komparatorët, oscilatorët, shndërruesit A/D, shndërruesit D/A, shndërrimi i kohës
Literatura: *M. Limani*: Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e katërbëdhjetë: Kompjuterët dhe ndërlidhja e qarqeve
Literatura: *M. Limani*: Elektronika – ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2008

Java e pesëmbëdhjetë: Vlerësimi i final

Vërejtje: terminin e vlerësimeve intermediare e cakton mësimdhënësi sipas planifikimit të lëndës që e ligjëron.

Metodat e vlerësimit:

- **Vlerësimi i parë: 15 %**
- **Vlerësimi i dytë: 15 %**
- **Vlerësimi final: 15%**
- **Detyra projektuese dhe angazhime tjera: 20 %**
- **Provimi final: 30%**
- **Total: 100%**

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: (mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.)

Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. J. Millman, C. Halkias, **Integrated Electronics**, McGraw Hill, 1972
2. D. Schilling, C. Belove, **Electronics Circuits**, McGraw Hill, 1973
3. Don Neamen, **Electronic Circuit Analysis and Design**, McGraw-Hill Education, 2000
4. Adel S. Sedra, Kenneth C. Smith, **Microelectronic Circuits**, Oxford University Press, 2007

PLANI MËSIMOR (SYLLABUSI) PËR LËNDËN MATEMATIKA III (K)

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULLTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Titulli i kursit (lëndës mësimore): MATEMATIKA III (për Kompjuterik)

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor/obligative

Viti i studimeve dhe semestri: Viti i dytë, semestri i tretë

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS: 5

Koha /lokacioni/: 8:00 – 9:30, Salla-626

Mësimdhënësit e kursit:

Dr. sc. Qefsere Doko Gjonbalaj, Kabineti nr. 705; (044) 179-786 ; konsultimet-dita e
Ejte ora 12.30-13.30; qefseregj@hotmail.com.

Qëllimet e kursit (modulit): Studenti të aftësohet që njohuritë e fituara përmes këtij kursi të mund t'i zbatojë si një aparaturë ndihmëse në studimet e lëndëve profesionale të inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike.

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:

1. Pas përfundimit të suksesëshëm të këtij kursi studenti është në gjendje të përshkruaj dhe modeloj problemet inxhinierike me anë të elementeve të matematikës.
2. Din të zgjidh dhe harton probleme të ndryshme në lëmin e profesionit të tij kur ka të bëjë me operacionet me bashkësit, përmes relacioneve dhe funksioneve përshkruan dhe zgjidh problemet që lidhen me problemet e kompjuterikës, ndërsa me anë të teoris së grafeve dhe elementeve tjera projekton dhe zhvillon ato probleme.

3. Në hulumtimet e dukurive të ndryshme elektrike dhe kompjuterike konstaton lidhjet funksionale të madhësive të asaj dukurie e pastaj me njehsime matematikore përshkruan dhe shqyrton ato lidhje funksionale, din të gjejë vlerat maksimale të tyre dhe në tërësi me anën e teoris së grafeve i vën në dukje vetitë e tyre.

Metodologjia e mësimdhënies: ligjëratë, diskutim, seminare, prezantime dhe punë në grupe.

Literatura bazë:

1. **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002.*
2. **Mathematics for Electrical Engineering and Computing**, **Mary Attenborough** AMSTERDAM BOSTON, 2003.
3. **Discrete Mathematics and its Applications**, **Kenneth H. Rosen**, Fourth Editon, Boston 1999.
4. 2000 SOLVED PROBLEMS IN **Discrete Mathematics** by Ph.D. Seymour Lipschutz Temple University, Ph.D.Marc Lipson University of Georgia; 1992.
5. Hamiti E. - **Matematika III/2**, Prishtinë 1999.
6. **Mathematics for Engineers** A Modern Interactive Approach (includes CD-ROM) Second Edition **Anthony Croft** Loughborough University, **Robert Davison** De Montfort University, 2004.
7. **Advanced Modern Engineering Mathematics** Third Edition, Glyn James, England 2004

Plani i detajizuar i mësimit për një semestër:

Java e parë : Bashkësitë dhe veprimet me to. Diagramet e Venit. Gjeneralizimi i unionit dhe prerjes. Numri Kardinal. Bashkësia partitive. Algjebra e bashkësive.

Literatura: **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002*, faqe 73-94.

Discrete Mathematics and its Applications, **Kenneth H. Rosen**, Fourth Editon, Boston 1999, faqe 38-56.

Java e dytë: Familjet e bashkësive. Particioni i bashkësisë. Teknikat e numërimit. Produkti karteziar. Paraqitja kompjuterike e bashkësive.

Literatura: **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002*, faqe 95-128.

Qefsere Doko Gjonbalj - **Matematika Diskrete** (skript), Prishtinë 2006, faqe 37-50.

Java e tretë: Relacionet. Përkufizimi dhe paraqitja e relacioneve. Relacionet e kombinuara. Relacionet n-are dhe zbatimi i tyre. Vetit e relacioneve. Unioni dhe prerja e relacioneve.

Literatura: **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002*, faqe 148-168.

Qefsere Doko Gjonbalj - **Matematika Diskrete** (skript), Prishtinë 2006, faqe 58-65.

Java e katërt: Relacioni i ekuivalencës dhe faktor bashkësitë. Relacioni i renditjes. Diagrami Hasse. Zbatimi i relacioneve në kompjuterik.

Literatura: **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002*, faqe 169-199.

Discrete Mathematics and its Applications, **Kenneth H. Rosen**, Fourth Edition, Boston 1999, faqe 374-408.

Java e pestë: Funkzionet. Përkufizimi dhe shembuj. Kompozimi i funksioneve. Funkzioni injektiv dhe surjektiv. Grafi i funksionit dhe disa funksione të rëndësishme.

Literatura: **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002*, faqe 214-254.

Qefserë Doko Gjonbalj - **Matematika Diskrete** (skript), Prishtinë 2006, faqe 51-57.

Mathematics for Engineers A Modern Interactive Approach (includes CD-ROM) Second Edition **Anthony Croft** Loughborough University, **Robert Davison** De Montfort University, 2004, faqe 125-150.

Java e gjashtë: Funkzioni bijektiv dhe funksioni invers. Numri kardinal. Zbatimi i funksioneve në kompjuterik. Shembuj.

Literatura: **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002*, faqe 254-278.

Discrete Mathematics and its Applications, **Kenneth H. Rosen**, Fourth Edition, Boston 1999, faqe 56-80.

Vlerësimi i parë intermediar

Java e shtatë: Strukturat algjebrike. Veprimet binare dhe vetit e tyre. Grupet dhe nëngrupet. Disa familje të grupeve.

Literatura: **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002*, faqe 355-390.

Qefserë Doko Gjonbalj - **Matematika Diskrete** (skript), Prishtinë 2006, faqe 66-80.

Java e tetë: Homomorfizmi dhe izomorfizmi i grupeve. Strukturat algjebrike me dy veprime. Unazat dhe fushat. Kodet e grupit.

Literatura: **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002*, faqe 391-430.

Qefserë Doko Gjonbalj - **Matematika Diskrete** (skript), Prishtinë 2006, faqe 80-85.

Java e nëntë: Teoria e grafeve. Kuptimet themelore të teoris së grafeve dhe shembuj. Rruga dhe qarku. Prezentimi matricor i grafit. Grafet e kalueshëm.

Literatura: **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002*, faqe 487-514.

Discrete Mathematics and its Applications, **Kenneth H. Rosen**, Fourth Edition, Boston 1999, faqe 438-490.

Qefserë Doko Gjonbalj - **Matematika Diskrete** (skript), Prishtinë 2006, faqe 86-110.

Java e dhjetë: Izomorfizmi i grafeve dhe nëngrafet. Drujt (Trees). Rrjetat lokale dhe drujt lidhës minimal. Grafet planare. Grafet e orientuara.

Literatura: **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002*, faqe 515-550.

Discrete Mathematics and its Applications, **Kenneth H. Rosen**, Fourth Edition, Boston 1999, faqe 528-560.

2000 SOLVED PROBLEMS IN **Discrete Mathematics** by Ph.D. Seymour Lipschutz Temple University, Ph.D.Marc Lipson University of Georgia; 1992

Java e njëmbëdhjetë: Zbatimi i teoris së grafeve. Grafi me peshë. Strategji të ndryshme të hulumtimit. Rruga më e shkurt dhe problemi i shitësit. Rrjetat dhe rryma.

Literatura: **Discrete Mathematics for New Technology** Second Edition **Rowan Garnier** and **John Taylor** *University of Brighton, UK 2002*, faqe 551-612.

Discrete Mathematics and its Applications, **Kenneth H. Rosen**, Fourth Edition, Boston 1999, faqe 562-580.

2000 SOLVED PROBLEMS IN **Discrete Mathematics** by Ph.D. Seymour Lipschutz Temple University, Ph.D.Marc Lipson University of Georgia; 1992

Vlerësimi i dytë intermediar

Java e dymbëdhjetë: Probabilitet me statistikë. Ligjet e probabilitetit. Probleme të ndryshme. Zbatimi i ligjeve të probabilitetit në qarqet elektrike.

Literatura: **Mathematics for Electrical Engineering and Computing**, **Mary Attenborough** AMSTERDAM BOSTON, 2003, faqe 493-515.

Mathematics for Engineers A Modern Interactive Approach (includes CD-ROM) Second Edition **Anthony Croft** Loughborough University, **Robert Davison** De Montfort University, 2004, faqe 1038-1119.

Java e trembëdhjetë: Statistik. Modelimi statistikor. Distribuimi normal. Distribuimi eksponencial. Distribuimi binomial.

Literatura: **Mathematics for Electrical Engineering and Computing**, **Mary Attenborough** AMSTERDAM BOSTON, 2003, faqe 516-526.

Mathematics for Engineers A Modern Interactive Approach (includes CD-ROM) Second Edition **Anthony Croft** Loughborough University, **Robert Davison** De Montfort University, 2004, faqe 1038-1119.

Java e katërbëdhjetë: Seritë Furie. Hyrje. Funkcionet periodike. Serit sin dhe cos. Serit Furie të funksioneve periodike dhe simetrike.

Literatura: **Mathematics for Electrical Engineering and Computing, Mary Attenborough**
AMSTERDAM BOSTON, 2003, faqe 418-430.

Hamiti E. - **Matematika III/2**, Prishtinë 1999, faqe 195-216.

Advanced Modern Engineering Mathematics Third Edition, Glyn James,
England 2004, faqe 267-284.

Java e pesëmbëdhjetë: Serit Furie në formën komplekse. Zbatimi i seris Furie në kompjuterik.

Literatura: **Mathematics for Electrical Engineering and Computing, Mary Attenborough**
AMSTERDAM BOSTON, 2003, faqe 418-430.

Advanced Modern Engineering Mathematics Third Edition, Glyn James,
England 2004, faqe 284-293.

Vërejtje: Literaturën që kam përdorur gjatë këti kursi ju kam shpërnda studentëve në mënyrë elektronike.

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i parë: 25%

Vlerësimi i dytë: 25%

Detyrat e shtëpisë, seminarët dhe prezentimet 10%

Vijimi i rregullt 5%

Provimi final 35%

Total 100%

Politika akademike dhe rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë.

Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. Qefsere Doko Gjonbalj - **Matematika Diskrete** (skript), Prishtinë 2006.

2. Hamiti E. - **Matematika I**, Prishtinë 1995.

Modeli i Planit mësimor të lëndës

Syllabusi

Departamenti: Lëndët bazike të inxhinierisë elektrike

Fakulteti/Njësia akademike: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Titulli i kursit (lëndës mësimore): Sinjalet dhe Sistemet

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor / Obligative

Viti i studimeve dhe semestri: Viti i dytë, Semestri III

Numri i orëve: 2+2

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 6

Koha/lokacioni:

Mësimdhënësi i kursit: Dr. sc. Ilir Limani, Prof.; Zyra: 628, Telefoni: 038 554 896, e-mail: ilir.limani@fiek.uni-pr.edu, dhe termini i caktuar për bisedë me studentët:

- e martë: 12⁰⁰ : 14³⁰

Qëllimet e kursit (modulit):

Kjo lëndë konsiderohet si lëndë themelore për studentët e inxhinierisë elektrike, në veçanti për ata që studimet do t'i vazhdojnë në drejtimet e telekomunikimeve apo të rregullimit automatik.

Qëllimet e lëndës janë:

- që studenti të njohet me konceptet themelore për sinjale dhe sisteme,
- që studenti të njohet me metodat themelore për analizë dhe sintezë të sinjaleve dhe sistemeve dhe të fitoj shkathtësi në zbatimin e tyre.

Parakushtet: Nuk ka

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

- Të kuptoj konceptet themelore për sinjalet dhe sistemet, në kohë të vazhduar dhe atë diskrete, si dhe të përcaktoj vetitë e tyre.
- Të kuptoj dhe të zbatoj metodat themelore të analizës së sinjaleve dhe të sistemeve në domenin kohor.

- Të kuptoj dhe të interpretoj metodat e bazike të analizës së sinjaleve dhe të sistemeve në domenin frekuencor, përmes transformimeve Furie, si në kohë të vazhduar ashtu edhe në atë diskrete.
- Të kuptoj konceptet themelore për filtrimin, mostrimin dhe për mënyrat themelore të modulimit të sinjaleve.
- Të zbatoj metodat e analizës së sinjaleve dhe të sistemeve të kohës së vazhduar në domenin e frekuencës komplekse s përmes transformimit të Laplasit.
- Të zbatoj metodat e analizës së sinjaleve dhe të sistemeve të kohës diskrete në domenin e frekuencës komplekse z përmes z -transformimit.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, zgjidhje e problemeve, diskutim dhe punë në grupe.

Literatura bazë:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Plani i hollësishëm i mësimit për një semestër:

Java e parë: Koncepti i sinjalit dhe llojet e tij. Vetitë e sinjaleve dhe veprimet me sinjale.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e dytë: Koncepti i sistemit. Llojet e sistemeve dhe vetitë e tyre.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e tretë: Përshkrimi i sistemeve lineare dhe invariante në zhvendosje përmes ekuacioneve diferenciale dhe të diferencës.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e katërt: Përshkrimi i sistemeve diskrete, linearë dhe invariant në zhvendosje përmes përgjigjes impulsive dhe përcaktimi i daljes përmes shumëzimit të sinjaleve diskrete.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e pestë: Përshkrimi i sistemeve të kohës së vazhduar, linearë dhe invariant në zhvendosje përmes përgjigjes impulsive dhe përcaktimi i daljes përmes integralit thurës. Shembuj të thurjes së sinjaleve të vazhduara.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e gjashtë: Vlerësimi i parë i ndërmjetëm

Java e shtatë: Përshkrimi i sinjaleve të vazhduara periodike përmes serisë Furie. Përshkrimi i sinjaleve të vazhduara aperiodike përmes transformimit Furie dhe vetitë e transformimit Furie.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e tetë: Përgjigja frekuencore e sistemit. Transformimi i përgjithësuar Furie për sinjale të vazhduara. Shembuj të zbatimit të transformimit Furie.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e nëntë: Analiza e sistemeve në domenin frekuencor. Filtrat ideal. Modulimi amplitudor i zakonshëm dhe ai amplitudës së pulseve. Multipleksimi dhe demultipleksimi i sinjaleve të moduluara.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e dhjetë: Transformimi Furie në kohë diskrete. Analiza e sinjaleve dhe sistemeve diskrete në domenin frekuencor.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e njëmbëdhjetë: Transformimi i Laplasit dhe vetitë e tij. Transformimi i kundërt i Laplasit dhe metodat për përcaktimin e tij.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e dymbëdhjetë: Zgjidhja e ekuacioneve diferenciale përmes transformimit njëanësor të Laplasit. Funkzioni transmetues i sistemit. Përshkrimi i qarqeve lineare elektrike në domenin e frekuencës komplekse s . Përshkrimi i sistemeve përmes bllok-diagrameve.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e trembëdhjetë: z-Transformimi dhe vetitë e tij. z-Transformimi i kundërt dhe metodat e përcaktimit të tij.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e katërbëdhjetë: Zgjidhja e ekuacioneve të diferencës përmes z-transformimit njëanësor. Funkzioni transmetues i sistemit diskret. Cilësimi i sistemeve diskrete përmes zerove dhe poleve të funksionit transmetues dhe stabiliteti i sistemit.

Literatura:

1. “*Schaum's Outline of Theory and Problems of Signals and Systems*”, Hwei P. Hsu, 1995, McGraw-Hill.
2. “*Transparencat dhe shënime të shtypura të ligjëratave*”, Prof. Ilir Limani, Dr.sc.

Java e pesëmbëdhjetë: Vlerësimi i dytë i ndërmjetëm

Vërejtje: Terminin e vlerësimeve e cakton mësimdhënësi sipas planifikimit të lëndës që e ligjëron.

Metodat e vlerësimit:

- **Vlerësimi i parë: 30%**
- **Vlerësimi i dytë: 30%**
- **Provimi final: 40%**
- **Total: 100%**

Vërejtje: Vlerësimet e ndërmjetme përbëhen nga zgjidhja e detyrave. Konsiderohet se studenti kualifikohet për provimin final, që përbëhet nga pyetjet teorike, në qoftë se ai e kalon pragun prej 50% të totalit të poenëve nga këto vlerësime. Studentët, përndryshe i nënshtrohen provimit dy-pjesësh, ku sërish pjesa e parë konsiderohet kualifikuese dhe merr pjesë me 60% në formësimin e rezultatit të provimit.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: (mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjëratat dhe ushtrimet dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.)

Literatura shtesë dhe bibliografia:

1. “*Fundamentals of Signals and Systems Using MATLAB*”, Kamen E, Heck B., Prentice-Hall, 1996.

2. “*Signals and Systems*”, Alan V. Oppenheim, 2nd ed., 1996, Prentice Hall.
-

Syllabusi

Departamenti/Fakulteti/Njësia akademike:

Departamenti i Kompjuterikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Titulli i kursit (lëndës mësimore): Bazat e të dhënave

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor/obligative

Viti i studimeve dhe semestri: Viti i II-të - Semestri III

Numri i orëve në javë: 2+0+2 (Viti i II-të)

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS: 5 ECTS

Koha/lokacioni: E hënë 9:00 – 11:00, Salla 616

Mësimdhënësi i kursit:

Dr. Ing. Lule Ahmedi

tel.: +381 38 554896 /ext. 237, ose 102

email: lule.ahmedi@fiek.uni-pr.edu

Orari i konsultimeve: E hënë 10:30 – 11:30, Kabineti 614

E mërkurë: 10:30 – 11:30, Kabineti 614

Qëllimet e kursit:

Që studentët të aftësohen të aplikojnë konceptet dhe teknikat bazë për dizajnimin dhe implementimin e aplikacioneve të bazave të të dhënave.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të jetë në gjendje që:

1. Të njeh teknikat e përshkrimit dhe menaxhimit të bashkësive të mëdha të të dhënave bazuar në modelin relacional.
2. Të shfrytëzoj eksperiencën e fituar këtu për të dizajnuar dhe implementuar projekte të bazave të të dhënave në praktikë.
3. Të dij për problemet tipike të bazave të të dhënave në praktikë, dhe krahasoj sistemet ekzistuese për të bërë zgjidhjen e duhur që eviton ato probleme.
4. Të identifikon aspektet e ndryshme relevante gjatë zhvillimit të projekteve të mëdha të bazave të të dhënave, dhe organizon shfrytëzimin e principeve themelore përkatësisht.

Metodologjia e mësimdhënjes:

Ligjërata, ushtrime, dhe punë praktike përmes realizimit të një projekti.

Literatura bazë:

Database Management Systems, prej Raghu Ramakrishnan, Johannes Gehrke

Plani i detajizuar i mësimit për një semestër:

Java e parë:

Hyrje dhe modeli relacional

Java e dytë:

Algjebra relacionale

Projekti, Pjesa 1

Java e tretë:

Datalog: Rregullat Logjike

Java e katërt:

SQL: Pyetësorët e thjeshtë, funksionet e agregimit

Java e pestë:

SQL: Grupimi, operacionet bashkësi, pyetësorët e mbërthyer, tipet komplekse të të dhënave dhe tabelat e mbërthyer

Dorëzimi: Projekti - Pjesa 1

Projekti - Pjesa 2

Java e gjashtë:

SQL: Krijimi i bazës së të dhënave dhe pamjeve, popullimi me të dhëna, SQL dhe gjuhët programuese

Java e shtatë:

SQL: Intergriteti dhe shkrepësit (ang. *triggers*)

Java e tetë:

SQL: Siguria e të dhënave

Vlerësimi i parë intermediar

Java e nëntë:

Dizanjimi konceptual: modeli ER dhe transformimi në modelin relacional

Dorëzimi: Projekti - Pjesa 2

Projekti - Pjesa 3

Java e dhjetë:

Dizajnimi formal: varësitë funksionale dhe format normale

Java e njëmbëdhjetë:

Dizajnimi formal: varësitë funksionale dhe format normale

Java e dymbëdhjetë:

Dizajnimi fizik

Dorëzimi: Projekti - Pjesa 3

Projekti - Pjesa 4

Java e trembëdhjetë:

Evaluimi i operatorëve / pyetësorëve

Java e katërmbëdhjetë:

Menaxhimi i transaksioneve

Java e pesëmbëdhjetë:

Rimëkëmbja në rast të rënies së sistemit

Dorëzimi: Projekti - Pjesa 4

Vlerësimi final

Metodat e vlerësimit:

Projekti: 40% (min 20%)

Vlerësimi i parë: 30% (min 15%)

Vlerësimi final: 30% (min 15%)

Vijimi i rregullt: vendimtar në rastet kufitare

Total 100%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Litaratura shtesë dhe bibliografia:

1. *Database Systems: The Complete Book* prej Garcia-Molina, Ullman and Widom
2. *A guide to the SQL standard* prej J. Date, H. Darwen
3. *SQL for Nerds* prej Philip Greenspun, në <http://philip.greenspun.com/sql/>

Modeli i Planit mësimor të lëndës

Syllabusi

Universiteti i Prishtinës

Departamenti/Fakulteti/Njësia akademike: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Titulli i kursit (lëndës mësimore) : Arkitektura dhe organizimi i kompjutereve

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor /obligative

Viti i studimeve dhe semestri: II, semestri 3

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 6

Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratës dhe salla): E mërkure 08.00, salla 616

Mësimdhënësi i kursit:

Qëllimet e kursit(modulit):

Njohja me strukturën dhe organizimin e kompjuterëve, ndërlidhja e komponentëve, memoria, CPU dhe përpunimi paralel i shënimeve

Rezultatet e pritura të nxënies

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti duhet:

1. të zotërojë njohuri themelore mbi arkitekturën e kompjuterëve,
2. të ketë njohuri themelore mbi funksionimin e komponentëve,
3. të ketë njohuri themelore mbi memorien, CPU dhe komunikimet në mes tyre
4. t'i kuptojë protokollet për përpunim paralel te shënimeve

Metodologjia e mësimdhënies: ligjëratë,seminar,dhe ushtrime numerike

Literatura bazë :

Autori

William Stallings

Titulli

Computer Organization and Architecture, ISBN=
9780131856448

Plani i detajizuar i mësimit për një semestër:

Java e parë: Hyrje: Hyrje, Zhvillimi i kompjuterit

Java e dytë: Ndërlidhja dhe funksionimi

Java e tretë: Memoria

Java e katërt: Cash memoria dhe memoria e jashtme

Java e pestë: Hyrja/dalje:

Java e gjashtë: Mbështetja e sistemit operativ

Java e shtatë: Njësia proceduese qendrore (CPU)

Java e tetë: Aritmetika logjike

Java e nëntë: Instruksionet- funksionimi dhe karakteristikat:

Java e dhjetë: CPU struktura dhe funksionet

Java e njëmbëdhjetë: Reduced Instruction Set Computers (RISCs)

Java e dymbëdhjetë: Organizimi Paralel

Java trembëdhjetë: Procesimi parallel

Java e katërbëdhjetë: Arkitektura IA-64

Java e pesëmbëdhjetë: Njësia kontrolluese.

Vërejtje: terminin e vlerësimeve intermediere e cakton mësuesi sipas planifikimit të lëndës që e ligjëron.

Metodat e vlerësimit:

1. Vijimi i ligjëratave dhe ushtrimeve: 10 pikë.
2. Pjesës praktike – detyrat e shtëpisë: 40 pikë.

3. Pjesës me shkrim – testi: 50 pikë
Totali(max): 100 pikë

Pjesa me shkrim – testi: 50 pikë
Testi ka 25 pyetje me 4 përgjigje të mundshme,

- Përgjigja e saktë: +2 pikë,
- Përgjigja e gabueshme: -2 pikë
- Pa përgjigje: -1 pikë

Për të kaluar provimin:

- Minimum nga vijimi 25%, pra 3 pikë
- Minimum nga pjesa praktike 25%, pra 10 pikë
- Minimum nga testi 25%, pra 13 pikë, dhe
- Shuma nga pika 1, 2 dhe 3 duhet te jetë më e madhe se 49 pikë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: (mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.)

Litaratura shtesë dhe bibliografia:

Nuk ka.

Modeli i Planit mësimor të lëndës

Syllabusi

Universiteti i Prishtinës

Departamenti/Fakulteti/Njësia akademike: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Titulli i kursit (lëndës mësimore) : Rrjetat Kompjuterike

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor /obligative

Viti i studimeve dhe semestri: III, semestri 5

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 6

Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratës dhe salla): E marte 1300, salla 616

Mësimdhënësi i kursit:

Emri: Dr. techn Blerim Rexha, Prof. Ass.

Mobile: 044-627251,

Email: blerim.rexha@fiek.uni-pr.edu ,

Termini për student: E marte 14.30 -15.30

Qëllimet e kursit(modulit):

Njohja me ISO modelin shtresor për rrjeta, njohja me protokollat për komunikim, përshkrimi dhe funksionimi i shërbimeve në nivelin e aplikacionit, transportit, rrjetës, lidhjes dhe fizikë.

Rezultatet e pritura të nxënies

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje:

5. të zotërojë njohuri themelore mbi shtresat e protokollit dhe te shërbimeve,
6. të ketë njohuri themelore mbi TCP/IP protokollat,.
7. të jetë në gjendje t'i aplikoj protokollat,
8. te jete në gjendje te beje konfigurimin e rrjetave
9. të ketë njohuri themelore mbi aplikacionet e shpërndara në rrjete,
10. të jetë në gjendje të bëjë menaxhimin e rrjetave,

11. t'i kuptoje aplikacionet që bazohen në TCP/IP protokolle

Metodologjia e mësimdhënies: ligjëratë,seminar,dhe ushtrime numerike

Literatura bazë :

Autori

James F. Kurose &

Keith W. Ross

Douglas Comer

Titulli

Computer Networking

Internetworking with TCP/IP , Principles, Protocols, and Architecture

Plani i detajizuar i mësimit për një semestër:

Java e parë: Rrjetat Kompjuterike dhe Interneti: Çka është Interneti, Rrjetat, Lidhjet fizike,

Java e dytë: Rrjetat Kompjuterike dhe Interneti: Protokollat shtesore dhe shërbimet, Internet Service Provider (ISP), Historia e Internetit

Java e tretë: Shtresa e aplikacionit: Principet e aplikacioneve në rrjete, Ueb, HTTP

Java e katërt: Shtresa e aplikacionit: FTP, posta elektronike, DNS dhe ueb serveri

Java e pestë: Shtresa e transportit: Hyrje në shërbimet e shtresës së transportit, Multipleksimi dhe demultipleksimi, Transferi i besueshem i shënimeve,

Java e gjashtë: Shtresa e transportit;TCP Protokollit, Etheral

Java e shtatë: Shtresa e rrjetës: Routing, Modeli i shërbimeve në rrjete, Qarqet virtuale dhe datagramet në rrjete, Portat

Java e tetë: Shtresa e rrjetës: IP Protokollit Algoritmet për routing, Routimi në Internet

Java e nëntë: Shtresa e lidhjes: Shërbimet e shtresës së lidhjes, Kodet për detektim të gabimeve, CRC, MAC,

Java e dhjetë: Shtresa e lidhjes:: LAN, Ethernet, Hubs & Switches, PPTP Protokollit

Java e njëmbëdhjetë: Rrjetat mobile dhe pa tela:, CDMA, WiFi,

Java e dymbëdhjetë: Rrjetat mobile dhe pa tela: Mobile IP, Cellular Architecture

Java trembëdhjetë: Rrjetat për multimedia : Aplikacionet për Multimedia, Video dhe audio streaming,

Java e katërmbëdhjetë: Rrjetat për multimedia: IP Telefonia, Protokolet për real time

Java e pesëmbëdhjetë: Konfigurimi i rrjeteve për shtëpi dhe zyra te vogë (SOHO): Ueb routing, WLAN, NAT

Vërejtje: terminin e vlerësimeve intermediere e cakton mësimdhënësi sipas planifikimit të lëndës që e ligjëron.

Metodat e vlerësimit:

4. Vijimi i ligjëratave dhe ushtrimeve: 10 pikë.

5. Pjesës praktike – detyrat e shtëpisë: 40 pikë.

6. Pjesës me shkrim – testi: 50 pikë

Totali(max): 100 pikë

Pjesa me shkrim – testi: 50 pikë

Testi ka 25 pyetje me 4 përgjigje të mundshme,

- Përgjigja e saktë: +2 pikë,
- Përgjigja e gabueshme: -2 pikë
- Pa përgjigje: -1 pikë

Për të kaluar provimin:

- Minimum nga vijimi 25%, pra 3 pikë
- Minimum nga pjesa praktike 25%, pra 10 pikë
- Minimum nga testi 25%, pra 13 pikë, dhe
- Shuma nga pika 1, 2 dhe 3 duhet të jetë më e madhe se 49 pikë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: (mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjëratat dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.)

Litaratura shtesë dhe bibliografia:

Nuk ka.

Modeli i Planit mësimor të lëndës

Syllabusi

Universiteti i Prishtinës

Departamenti/Fakulteti/Njësia akademike: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Titulli i kursit (lëndës mësimore) : Siguria e të dhënave

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor /zgjedhore

Viti i studimeve dhe semestri: III, semestri 5

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS : 6

Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratës dhe salla): E mërkure 08.15, salla 616

Mësimdhënësi i kursit:

Emri: Dr. techn Blerim Rexha, Prof. Ass.

Mobile: 044-627251,

Email: blerim.rexha@fiek.uni-pr.edu,

Termini për student: E mërkure 09.30 -10.30

Qëllimet e kursit(modulit):

Njohja me algoritmet për enkriptim, masat për rritjen e sigurisë së të dhënave, certifikata digjitale, smart kartela dhe aplikimi i tyre në praktikë

Rezultatet e pritura të nxënies

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti duhet:

12. të zotërojë njohuri themelore mbi kriptografinë,
13. të ketë njohuri themelore mbi enkriptimin simetrik dhe josemetrik,
14. të jetë në gjendje t'i aplikoj algoritmet për enkriptim
15. të ketë njohuri themelore mbi smart kartelat dhe aplikimin e tyre në praktikë,
16. të jetë në gjendje të bëjë menaxhimin e çelësave publik,
17. t'i kuptojë protokollet tjera që bazohen në kriptografi

Metodologjia e mësimit: ligjëratë,seminar,dhe ushtrime numerike

Literatura bazë :

<i>Autori</i>	<i>Titulli</i>
Bruce Schneier	Applied Cryptography, ISBN=0-471-12845-7, 1996
Alfred J. Menezes, Paul C. van Oorschot and Scott A. Vanstone	Handbook of Applied Cryptography , ISBN: 0-8493-8523-7 1996, po ashtu onlilne në: http://www.cacr.math.uwaterloo.ca/hac/
Cryptograpy Decrypted	H.X. Mel & Doris Baker, ISBN=0-201-61647-5, 2001
C# Data Security	Matthew MacDonald & Erik Johansson, ISBN=1-86100-801-5, 2003

Plani i detajzuar i mësimit për një semestër:

Java e parë: Bazat e kriptografisë: Hyrje në kriptografi, Terminologjia, Steganografia, Algoritmet

Java e dytë: DES-i (Enkriptimi simetrik): 12.1 Hyrje, 12.2 Pershkrimi i DES-it, 12.3 Siguria e DES-it, 12.6 Variantet e DES –it.

Java e tretë: RSA (Enkriptimi asimetrik, algoritmet me çelësa publik): 19.3 RSA

Java e katërt: Hesh funksionet 2.3 Funksionet e njëkahëshe, 18 Hash funksionet njëkahëshe, 18.5 MD5, 18.7 SHA,

Java e pestë: Nënshkrimet digjitale: 2.6 Nënshkrimet digjitale, 2.7 Nënshkrimet digjitale dhe enkriptimi.

Java e gjashtë: Menaxhimi i çelësve sekret, privat dhe publik: 8.1 Gjenerimi i çelësve, 8.3 Shkëmbimi i çelësve,

Java e shtatë: X.509 çertifikatat: Çertifikatat digjitale, X.509 çertifikatat, ISO Standardi

Java e tetë: Public Key Infrastructure (PKI) 8.4 Verifikimi i çelësve, 8.6 Freskimi i çelësve, 8.7 Ruajtja e çelësve, 8.8 Çelësat rezervë, 8.12 Menaxhimi i çelësve publik.

Java e nëntë: Standardet për enkriptim (PKCS#1 – PKCS#15): 24.14 Përshkrimi dhe funksioni i secilit standard.

Java e dhjetë: Smart kartelat I: Hyrje, Llojet e smartcard-ave, Vetitë fizike dhe elektrike, Sistemi operativ për smartcard-sa.

Java e njëmbëdhjete: Smart kartelat II:, Shkëmbimi i informatave me smartcards-a , Smartcard komandat (urdherat).

Java e dybëdhjetë: Smart kartelat III:, PC/SC Arkitektura, Smartcards-at pa kontakte, Struktura e memories, Standardet, Aplikacionet me smartcards-a po kontakt etj.

Java trembëdhjetë: Përdorimi i funksioneve kriptografike : CAPICOM dhe CryptoAPI

Java e katërbëdhjetë: Aplikimi i teknologjive për enkriptim në raste konkrete: Shkëmbimi i email-ave në form të enkriptuar,

Java e pesëmbëdhjetë: Aplikimi i teknologjive për enkriptim në raste konkrete Pagesat elektronike përmes Internetit, Paratë elektronike, Pagesat me anë të smart kartelatave. E-commerce. E-government.

Vërejtje: terminin e vlerësimeve intermediere e cakton mësimdhënësi sipas planifikimit të lëndës që e ligjëron.

Metodat e vlerësimit:

7. Vijimi i ligjëratave dhe ushtrimeve: 10 pikë (5 ligjërata + 5 pikë ushtrime).
8. Pjesës praktike – detyrat e shtëpisë: 40 pikë.
9. Pjesës me shkrim – testi: 50 pikë

Totali (max): 100 pikë

Pjesa me shkrim – testi: 50 pikë

Testi ka 25 pyetje me 4 përgjigje të mundshme,

- Përgjigja e saktë: +2 pikë,
- Përgjigja e gabueshme: -2 pikë
- Pa përgjigje: -1 pikë

Për të kaluar provimin:

- Minimum nga vijimi 25%, pra 3 pikë
- Minimum nga pjesa praktike 25%, pra 10 pikë
- Minimum nga testi 25%, pra 13 pikë, dhe
- Shuma nga pika 1, 2 dhe 3 duhet te jetë më e madhe se 49 pikë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: (mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.)

Litaratura shtesë dhe bibliografia:

Nuk ka.

Komunikimi Njeri-Kompjuter

S Y L L A B U S I

Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
Departamenti i Kompjuterikes

Titulli i kursit (lëndës mësimore) : **Komunikimi Njeri Kompjuter**
Niveli dhe lloji i kursit: **Bachelor / Obligative**
Viti i studimeve dhe semestri: **II, Semestri 4**
Vlera në kredi ECTS : **5**

Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratës dhe ushtrimet dhe salla):
Të Mërkurën nga ora 08:00-09:30 Ligjërata dhe 10:00-13:30 Ushtrime

Mësimdhënësi i kursit:

Mr. Sc. Ing. Isak Shabani, në mbikëqyrje të Dr. sc. Lule Ahmedi

Tel: +377 44 649676

Email: për komunikim isak.shabani@fiek.uni-pr.edu ose shabani_i@yahoo.com

Qëllimet e kursit:

Që studentët të aftësohen të kuptojnë konceptet dhe teknikat të komunikimit njeri-kompjuter

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi, studenti do të jetë në gjendje që:

5. Të kuptoj konceptet kryesore të komunikimit njeri-kompjuter
6. Të jetë në gjendje të realizojnë projekte të ndryshme

Metodologjia e mësimdhënies:

Ligjërata, ushtrime, dhe punë praktike përmes realizimit të GUI në gjuhën programuese C# dhe në Tcl/Tk.

Kërkesat

- Aftësi programuese
- Studenti aktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve

Literatura bazë :

Autor

Alan Dix, Janet Finlay, Gregory D. Abowd,
Russell Beale

Titulli

Human Computer Interaction

Plani i detalizuar i mësimit

Java	Tema
1	Hyrje ne lenden Komunikimi Njeri-Kompjuter
2	Njeriu
3	Te menduarit
4	Kompjuteri
5	Pajisjet kompjuterike
6	Realiteti Virtual
7	3D interaksioni
8	Interaksioni Njeri Kompjuter
9	Shtat fazat e Normanit
10	Paradigma ne HCI
11	Dizajnimi i interaksionit
12	HCI ne softuer
13	Realizimi i GUI në gjuhen programuese C#
14	Teknikat e programimit në gjuhen programuese Tcl/Tk
15	Realizimit të GUI në gjuhen programuese Tcl/Tk

Vërejtje: terminin e vlerësimeve intermediere e cakton mësimdhënësi sipas planifikimit të lëndës që e ligjëron.

Metodat e vlerësimit:

10. Vijimi në ligjërata: **5 pikë.**
11. Vijimi në ushtrime: **5 pikë.**
12. Pjesës praktike – Projekti: **30 pikë.**
13. Pjesës me shkrim Testet ose provimi përfundimtarë: **60 pikë.**

Studentët të që nuk vijon mësimin, që nuk marrin pjesë në projekt dhe që nuk ju nënshtrohen testeve në provim mund të arrijn maksimum **60 pikë** nga **100 pikë** të mundshme.

Për të kaluar provimin:

- Shuma e pikëve nga pika 1, 2 , 3 dhe 4 duhet te jetë më e madhe se **49 pikë.**

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular,hyrja në sallë me kohë, etj.